



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

# QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

## STUDIM

IMPAKTI I TATIMIT NË RITJEN EKONOMIKE

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	3
Konceptet Bazë të Tatimit .....	5
Sistemet tatimore dhe klasifikimi i tyre .....	6
Shkollat e mendimit ekonomik .....	6
Modelet teorike të tatimit dhe zhvillimit ekonomik .....	7
Politikat fiskale .....	8
Karakteristikat e strukturës tatimore .....	8
Efektet që prodhojnë llojet e ndryshme të tatimit.....	10
Efektet e TVSH-së në rritjen ekonomike.....	12
Të ardhurat personale dhe ndikimi në ekonomi.....	14
Komponentë të tatimit në ndryshimet ekonomike .....	15
Rreth politikave tatimore të BE .....	16
Klima e favorshme e biznesit.....	18
Biznesi i vogël dhe roli i tij në ekonomi .....	18
Normat tatimore dhe indikatorët ekonomikë për vende të ndryshme.....	19
Literatura e përdorur .....	22

## Hyrje

Rëndësia e temës rrjedh nga roli që ka tatimi mbi të ardhurat në gjenerimin e të ardhurave, buxhetore ndikimi i tyre në shpërndarjen e të ardhurave pas tatimit dhe efektet në një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve ekonomike. Nuk ka dyshim se politika tatimore mund ndikojë në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Reforma tatimore mund të përfshijë reduktime në normat e tatimit mbi të ardhurat si dhe masa për të zgjeruar bazën tatimore. Zgjerimi i bazës ka një efekt shtesë që të ndihmojë në zgjerimin e madhësisë së ekonomisë.

Në një kontekst ku për shumë qeveri kërkohet të përballen me shpenzime në rritje dhe kufizime fiskale, rritja e të ardhurave mbetet funksioni më i rëndësishëm i tatim-taksave, të cilat shërbejnë si mjeti kryesor për financimin e të mirave publike si ruajtja e rendit dhe ligjit dhe infrastrukturës publike. Duke supozuar një nivel të caktuar të ardhurash që duhet të mblidhet, që varen nga politikat ekonomike dhe fiskale të një vendi, ka një sërë parimesh të politikës tatimore të cilat tradicionalisht kanë udhëhequr zhvillimin e sistemeve tatimore. Këto përfshijnë neutralitetin, efikasitetin, sigurinë dhe thjeshtësinë, efektivitetin dhe drejtësinë si dhe fleksibilitetin.<sup>1</sup>

*Neutraliteti:* Tatimi duhet të jetë neutral dhe i barabartë ndërmjet formave të ndryshme të veprimtarive të biznesit. Një tatim ose taksë neutrale do të kontribuonte në efikasitet duke siguruar shpërndarje optimale të mjeteve të prodhimit. Në këtë kuptim, neutraliteti nënkupton edhe rritjen e të ardhurave duke minimizuar diskriminimin. Kjo nënkupton se të njëjtat parime të tatimit duhet të zbatohen për të gjitha format e biznesit.

*Efikasiteti:* Kostot e pajtueshmërisë me përmbushtjen e detyrimeve tatimore dhe të biznesit dhe të administrimit të tatimeve e taksave nga ana e administratës fiskale për çdo qeveri duhet të minimizohen sa më shumë që të jetë e mundur.

*Siguria dhe thjeshtësia:* Rregullat tatimore duhet të jenë të qarta dhe të thjeshta, të kuptueshme në mënyrë që tatimpaguesit të dinë se ku preken. Një tatim ose taksë e thjeshtë e bën më të lehtë për

---

<sup>1</sup> Fundamental principles of taxation, Chapter 2, [https://www.oecd-ilibrary.org/taxation/addressing-the-tax-challenges-of-the-digital-economy/fundamental-principles-of-taxation\\_9789264218789-5-en;jsessionid=L\\_LwVecexq4tAp8-e7fbA1mxvYiuoSRPdyDGMYS7.ip-10-240-5-72](https://www.oecd-ilibrary.org/taxation/addressing-the-tax-challenges-of-the-digital-economy/fundamental-principles-of-taxation_9789264218789-5-en;jsessionid=L_LwVecexq4tAp8-e7fbA1mxvYiuoSRPdyDGMYS7.ip-10-240-5-72)

tu kuptuar nga individët dhe bizneset, si detyrimet dhe të drejtat e tyre. Kompleksiteti favorizon gjithashtu planifikimin agresiv të tatimit, gjë që mund të shkaktojë humbje të pafavorshme për ekonominë.

*Efektiviteti dhe drejtësia:* Tatimi duhet të prodhojë të drejtën e marrjes së tatimit në vendin dhe kohën e duhur, duke shmangur p.sh. tatimet e dyfishta. Përveç kësaj, potenciali për evasion dhe shmangia duhet të minimizohen.

*Fleksibiliteti:* Sistemet e tatimeve duhet të jenë fleksibël dhe dinamikë për të siguruar që ato të mbajnë ritmin me teknologjinë dhe zhvillimet. Është e rëndësishme që një sistem tatimor të jetë dinamik dhe mjaft fleksibël për të përmbushur nevojat aktuale të të ardhurave të qeverive duke iu përshtatur nevojave në ndryshim në mënyrë të vazhdueshme.

## Konceptet Bazë të Tatimit

### ➤ Tatimet

Tatimet janë pagesa të detyrueshme të cilat individët dhe bizneset i bëjnë qeverisë për të financuar shpenzimet publike dhe për të realizuar funksione të ndryshme qeveritare.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të tatimeve:

- *Tatimet direkte:* Këto janë tatime të vendosura direkt mbi të ardhurat ose pasurinë e individëve dhe bizneseve, si p.sh. tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin e korporatave.
- *Tatimet indirekte:* Këto janë tatime të vendosura mbi mallrat dhe shërbimet, si p.sh. TVSH-ja (Tatim mbi Vlerën e Shtuar) dhe akcizat.

### ➤ Zhvillimi Ekonomik

Zhvillimi ekonomik përfshin përmirësimet në standardet e jetesës, rritjen ekonomike të qëndrueshme, uljen e varfërisë dhe pabarazisë, dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës në një vend. Indikatorët kryesorë përfshijnë PBB-në (Prodhimi i Brendshëm Bruto), shkallën e papunësisë, nivelin e arsimit, dhe qasjen në shërbime shëndetësore.

### ➤ Progresiviteti dhe Regresiviteti i Tatimeve

- *Tatimet progresive:* Tatime që rriten me rritjen e të ardhurave, që do të thotë se individët me të ardhura më të larta paguajnë një përqindje më të lartë të të ardhurave të tyre në formë tatim-taksash.
- *Tatimet regressive:* Ato që marrin një përqindje më të madhe nga të ardhurat e individëve me të ardhura më të ulëta.

### ➤ Elasticiteti Fiskal

Elasticiteti fiskal i referohet ndjeshmërisë së të ardhurave nga tatimet ndaj ndryshimeve në bazën e tyre. Elasticiteti i lartë nënkupton që ndryshimet në normat e tatimeve do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në të ardhurat e qeverisë.

## **Sistemet tatimore dhe klasifikimi i tyre**

Sistemet tatimore mbështeten në tri shtylla kryesore, në llojin e tatimit, bazën tatimore dhe nivelin e qeverisjes (Harvey S.R & Gayer T., 2008). Sipas llojit të tatimit dallojmë tatimet direkte që përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat e kompanive dhe të ardhura të tjera dhe tatimin mbi fitimet kapitalet, tatimet indirekte- që përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), akcizën, tatimet mbi konsumin dhe ato mbi mallrat dhe shërbimet. Tatimet mund të klasifikohen edhe sipas bazës tatimore si psh tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi pasurinë, tatimet mbi mallrat dhe shërbimet. Dhe së fundmi, tatimet ndahen edhe sipas nivelit të qeverisjes, pra në qendrore dhe lokale.

## **Shkollat e mendimit ekonomik**

Në shkencën e makroekonomisë ka dy shkolla kryesore të mendimit intelektual. Njëra prej tyre beson se tregjet funksionojnë më mirë në qoftë se nuk ndërhyhet në to, ndërsa tjetra beson se ndërhyrja shtetërore mund të përmirësojë dukshëm veprimtarinë e ekonomisë (Rudiger Dornbusch; Stanley Fischer, 2000, f. 23).

*Shkolla klasike*, e cila është edhe shkolla e parë e mendimit ekonomik, lidhet me ekonomistin skocez Adam Smith dhe ekonomistët britanikë si Robert Malthus dhe David Ricardo. Ideja kryesore e shkollës klasike është vetëregullimi i tregjeve. Ata besojnë se efënca e tregut sjell zhvillim ekonomik. Mekanizmat e çmimeve sillen si “një dorë e padukshme” në treg. Në terma makroekonomikë, ekonomistët klasikë mbështesin idenë se nëpërmjet një mekanizmi automatik vetërregullues ekonomia gjithmonë kthehet në ekuilibër. Sipas shkollës klasike, politika fiskale e duhur është ajo nëpërmjet së cilës shteti krijon mjedisin ekonomik në të cilin prona private mbrohet më së miri dhe sipërmarrjet private kanë nxitësit e duhur për më shumë prodhim dhe inovacion. Shpenzimet publike, sipas kësaj shkolle duhet të kufizohen në shpenzime për mbrojtje, sistemin ligjor, infrastrukturë, edukim, transport dhe një sistem administrativ të vogël dhe efëcent, ndërsa tatimet duhet të jenë relativisht të ulëta dhe rregullat mbi to të jenë minimale.

*Shkolla neoklasike* e mendimit ekonomik është njëkohësisht edhe baza e zhvillimit të teorive moderne të ekonomisë. Modelet e kësaj shkolle janë modele shkencore, me supozime dhe hipoteza dhe përpjekje për të derivuar nga parimet dhe rregullat e përgjithshme për sjelljen e bizneseve dhe konsumatorëve.

Klasikët e rinj dhe shkolla e tyre synojnë të shpjegojnë problemet dhe çështjet makroekonomike duke përdorur koncepte mikroekonomike si sjellja dhe pritjet racionale.

## Modelet teorike të tatimit dhe zhvillimit ekonomik

- **Teoria Keynesiane**

Teoria Keynesiane thekson rolin e qeverisë në nxitjen e kërkesës agregate për të nxitur rritjen ekonomike, veçanërisht në kohë recesioni. Sipas kësaj teorie, politika fiskale ekspansioniste (rritja e shpenzimeve publike dhe ulja e tatimeve) mund të stimulojë rritjen ekonomike duke rritur kërkesën agregate.

- **Teoria e Ofertës dhe Kërkesës**

Kjo teori thekson se tatimet ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve dhe prodhuesve. Tatimet më të larta mund të dekurajojnë prodhimin dhe investimet, ndërsa ato më të ulëta mund të nxisin aktivitetin ekonomik. Është e rëndësishme të arrihet një balancë që maksimizon të ardhurat publike pa dekurajuar rritjen ekonomike.

- **Teoria “Endogenous Growth” (rritje së brendshmi)**

Teoria e rritjes endogjene thotë se rritja ekonomike është kryesisht rezultat i forcave që lindin së brendshmi dhe jo të jashtme. Teoria e rritjes endogjene sugjeron se politika fiskale mund të ketë ndikime afatgjata në normën e rritjes ekonomike duke ndikuar në faktorët e brendshëm të ekonomisë, si investimet në kapital njerëzor, inovacionin, dhe teknologjinë. Tatime e taksa që mbështesin arsimin dhe kërkimin shkencor mund të nxisin rritjen ekonomike.

- **Laffer Curve (Kurba e Laffer-it)**

Kurba e Laffer-it ilustron marrëdhënien mes normës së tatimit dhe të ardhurave totale të qeverisë. Ajo sugjeron se ekziston një nivel optimal i tatimit që maksimizon të ardhurat. Tatimet shumë të larta mund të dekurajojnë punën dhe investimet, duke çuar në të ardhura më të ulëta, ndërsa tatimet shumë të ulëta mund të mos sigurojnë të ardhura të mjaftueshme.

- **Teoria e Shpërndarjes së Drejtë**

Kjo teori fokusohet në mënyrën se si tatimet mund të përdoren për të reduktuar pabarazinë ekonomike. Ajo sugjeron që një sistem i drejtë i tatimit duhet të sigurojë që individët me të ardhura më të larta të kontribuojnë më shumë, në mënyrë që të mbështeten shërbimet publike dhe të reduktohet pabarazia.

## Politikat fiskale

Për të ndërhyrë në sistemin ekonomik janë në dispozicion dy kategori të mëdha ndërhyrjeje. Politika monetare, pjesë e kategorisë së parë, e drejtuar nga Banka Qendrore, që kontrollon ekonominë nëpërmjet mekanizmave të saj përfshirë përshtatjen e normave të interesit. (Mishkin, 2010, p. 319). Kategoria e dytë përbëhet nga politika fiskale e kontrolluar kryesisht nga parlamenti dhe e zbatuar nga ekzekutivi, që kontrollon normat fiskale dhe shpenzimet publike.

### Karakteristikat e strukturës tatimore

Struktura e tatimeve duhet të bazohet mbi një grup parimesh të cilat pasqyrojnë qartësisht bazën filozofike të saj, por përsëri ajo duhet të pranojë kufizimet mbi metodat e tatimit që rrjedhin nga kombi, shteti dhe ekonomia lokale (Lee, Y. & Gordo, R.H, 2005). Në punimin e tyre mbi parimet e tatimeve e taksave Richardson dhe Hildreth përmendim pesë karakteristika të një sistemi ideal tatimesh e taksash. (Richardson A.J & Hildreth W.B, 1999, p. 23).

- *Besueshmëria dhe parashikimi i rritjes së të ardhurave*

Qëllimi kryesor i çdo sistemi tatimor është realizimi i të ardhurave për të financuar shërbimet publike. Qeveritë vendore dhe ato lokale varen më së shumti nga besueshmëria që kanë tatimpaguesit në përdorimin e duhur të të ardhurave të mbledhura dhe parashikimi i duhur i rritjes së të ardhurave, kjo pasi ato janë të detyruara të lëvizin brenda kufijve të buxhetit. Një ndër qëllimet e çdo qeverie duhet të jetë stabiliteti që ofron sistemi tatimor (kryesisht ligjet, por dhe administrimi i tyre). Përpara tyre shtrohet domosdoshmëria e gjetjes së një balance midis shërbimeve publike, që ajo dëshiron të ofrojë dhe tatimeve e taksave që ajo do të vendosi. Thënë të gjitha këto kuptojmë se një nga karakteristikat kryesore të strukturës së tatimeve e taksave është stabiliteti. Bizneset dhe individët preferojnë të kenë njohuri të mjaftueshme mbi ligjet tatimore dhe që ato të mos ndryshojnë shpesh.

- *Bazë e gjerë dhe norma të ulëta*

Askush nuk i do tatimet e taksat. Vendosija e tyre ndryshon sjelljen e individëve, i bën ata të gjejnë mënyra dhe rrugë për të shmangur pagesën e tyre. Më qëllim minimizimin e këtij lloj reagimi ndaj tatimeve e taksave ekonomistët sugjerojnë një bazë tatimore sa më të gjerë të jetë e mundur dhe norma tatimore sa më të ulëta. Baza e gjerë lë pak hapësirë për të shmangur tatimet, apo për të ndryshuar sjelljen. Ajo gjithashtu mban një lloj barazie në strukturën e tatimeve, pasi nuk përjashton askënd nga pagimi i tyre, pavarësisht mënyrës se si janë krijuar apo shpenzuar të ardhurat.

- *Zhvillimi dhe rritja ekonomike*

Qeveria vepron më mirë kur ekonomia e vendit është në rritje. Në asnjë mënyrë qeveritë nuk duan të dëmtojnë zhvillimin dhe rritjen ekonomike afatgjatë. Tatimet dhe taksat mund të ndikojnë si mbi zhvillimin ashtu edhe mbi rritjen ekonomike të një vendi. Struktura e tatim- taksave të një



shteti duhet të krijojë kushtet për një mjedis konkurrues, kjo edhe për faktin se kapitali është i lëvizshëm, dhe sidomos ajo pjesë e kapitalit që ende nuk është investuar.

- *Barazia dhe drejtësia*

Organet administruese të tatimeve nuk mund të kontrollojnë çdo tatimpagues dhe çdo tatim të paguar. Detyrimin për të paguar tatimin individët dhe bizneset duhet ti përgjigjen vullnetarisht. Për të realizuar këtë, ata duhet të besojnë se sistemi tatimor është i drejtë, në të kundërt do të përpiqen ta shmangin sa më shumë të jetë e mundur pagimin e tyre.

- *Thjeshtësia*

Thjeshtësia e ligjit tatimor ul jo vetëm kostot qeveritare të administrimit të ligjit tatimor, por edhe kostot e qytetarëve dhe të biznesit në kuptimin dhe zbatimin e tij.

Në dy dekadat e fundit, studime të shumta, nga autorë të shumtë janë bërë për të shpjeguar ndikimin e tatimit në rritjen ekonomike. Myles, G. (2009: 5), në një artikull të tij mbi rolin e tatimit në rritjen ekonomike ka theksuar se norma e rritjes mund të ndikohet nga zgjedhjet politike përmes efektit që kanë tatimet mbi vendimet ekonomike dhe ka theksuar efektet pozitive dhe negative të tatimit mbi rritjen. Efektet pozitive të tatimit qëndrojnë në atë se një rritje e tatimit siguron mjetet për financimin e shpenzimeve të ndryshme publike, të tilla si shpenzimet në infrastrukturë, arsim, shëndetësi të cilat mund ta rrisin produktivitetin në përgjithësi dhe në mënyrë indirekte mund të ndikojnë në normën e rritjes ekonomike. Efektet negative të tatimit, Myles, po ashtu i ka shpjeguar me rritjen e normës së tatimit, sipas të cilit një rritje në tatim redukton investimet në kapital si dhe ato në kërkime dhe zhvillim. Investime më të ulëta do të thotë më pak akumulim dhe inovacione kështu edhe normë më të ulët të rritjes. Si pasojë e kësaj shtetet nuk duhet të jenë të njëjta në përgjigje të politikës së tatimeve, psh. shtetet me infrastrukturë mirë të zhvilluar nuk mund të veprojnë njëjtë sikurse vendet me infrastrukturë të dobët. Disa vende kanë nevojë për akumulim në kapitalin njerzor, disa tjera kanë nevojë për investime në kërkim dhe zhvillim.

## **Efektet që prodhojnë llojet e ndryshme të tatimit<sup>2</sup>**

Tatimi ka një ndikim kompleks në rritjen ekonomike. Tatimet, veçanërisht mbi të ardhurat e korporatave dhe individuale, priren të ndikojnë në ulje në rritjen ekonomike. Megjithatë, efektet mund të ndryshojnë në varësi të llojit të tatimit, shkallës tatimore dhe mënyrës së zbatimit. Sipas një studimi të William Gale për Economic Studies at Brookings, fokusuar më së shumti në të ardhurat direkte, analizohet ndikimi i disa komponentëve:

*Ndikimi negativ i tatimeve mbi të ardhurat:*

- Rritja e tatimit mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat individuale dhe të korporatave, mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Për shembull, një rritje prej 1% në normën totale tatimore mund të çojë në një ulje afatgjatë të PBB-së reale për frymë prej 0.5% në 1%.

*Ndikimi pozitiv i tatimit mbi konsumin:*

- Tatimet dhe taksat e konsumit, si tatimet mbi vlerën e shtuar (TVSH), përgjithësisht shihen si më pak shtrembëruese dhe mund të kenë efekte pozitive në rritjen ekonomike. *Sfidat metodologjike:*

- Matja e ndikimit të ndryshimeve tatimore në rritjen ekonomike është sfiduese për shkak të kompleksitetit të reformave tatimore dhe nevojës për të kontrolluar faktorë të tjerë si shpenzimet e qeverisë dhe politika monetare.

*Efektet jolineare:*

- Efektet e tatimeve në rritje janë shpesh jolineare. Për shembull, me norma të ulëta tatimore, ndikimi mund të jetë i papërfillshëm, por me norma më të larta, dëmi ekonomik mund të rritet ndjeshëm.

*Dëshmi empirike:*

---

<sup>2</sup> Effects of Income Tax Changes on Economic Growth, William G. Gale, The Brookings Institution and Tax Policy Center, Andrew A. Samwick, Dartmouth College and National Bureau of Economic Research

- Studimet empirike, si ato që përdorin të dhëna nga vendet e OECD-së, konfirmojnë se rritja e tatimeve ka një ndikim negativ dhe të vazhdueshëm në rritjen ekonomike. Këto studime sugjerojnë gjithashtu se lloje të ndryshme tatimeve, të tilla si kontributet e sigurimeve shoqërore, mund të kenë efekte të ndryshme në prodhimin ekonomik.

Ndërsa tatimet mund të ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike, veçanërisht tatimi mbi të ardhurat, mbi konsumin dhe politikat tatimore të dizajnuara mirë mund të kenë efekte pozitive. Ndikimi i tatimeve në rritjen ekonomike është kompleks dhe i ndikuar nga faktorë të ndryshëm, duke e bërë vendimtare marrjen në konsideratë të këtyre nuancave gjatë hartimit të politikave tatimore.

## Efektet e TVSH-së në rritjen ekonomike<sup>3</sup>

Efektet e TVSH-së në rritjen ekonomike janë shumë jolineare. Përsa më poshtë do të tregojmë disa aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të dhënat për të cilin janë marrë nga një raport i kryer për BE nga disa institute kërkimi si IHS, CPB, CAPP, CASA dhe IFS, të cilat studiojnë efektet ekonomike të TVSH:

- Në normat e ulëta ose të moderuara të TVSH-së, ndikimi në rritjen afatgjatë është shumë i vogël. Për shembull, kur norma fillestare e TVSH-së është e ulët, efekti i rritjes është praktikisht zero.

- Megjithatë, me rritjen e normave të TVSH-së, ndikimi i tyre negativ në rritje rritet në mënyrë dramatike. Shumëzuesi i tatim-taksave bëhet më negativ kur rritet norma fillestare e tatimit dhe madhësia e ndryshimit të TVSH-së.

- Kjo marrëdhënie jolineare nënkupton që efekti i ndryshimeve të TVSH-së në prodhim ndryshon shumë në varësi të nivelit fillestar të tatimit (përqindja e TVSH kur është implementuar për herë të parë). Vendet me norma të larta fillestare të TVSH-së priren të përjetojnë ndikime më të mëdha negative në shitjet sipas fazave të prodhimit dhe shpërndarjes kur rritin TVSH-në krahasuar me vendet me norma fillestare të ulëta.

- Këto gjetje ndihmojnë në harmonizimin e vëzhgimit se normat e TVSH-së të miratuara nga vende të ndryshme janë përgjithësisht të pakorreluara me performancën e tyre të rritjes.

Normat e larta të TVSH-së mund të kenë pasoja të rëndësishme negative afatgjata në rritjen ekonomike:

*Efektet jolineare:* Me rritjen e normave të TVSH-së, ndikimi i tyre negativ në rritje bëhet më i theksuar. Normat e ulëta ose të moderuara të TVSH-së kanë një ndikim minimal në rritjen afatgjatë, por normat më të larta mund të çojnë në reduktime të konsiderueshme të prodhimit ekonomik.

*Rritja dhe stimujt:* Normat e larta të TVSH-së mund të ulin ndjeshëm stimujt privatë për të investuar dhe për të inovuar, të cilat janë thelbësore për rritjen ekonomike afatgjatë. Kjo mund të

---

<sup>3</sup> [https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2016-09/vat\\_rates\\_structure\\_final\\_report.pdf](https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2016-09/vat_rates_structure_final_report.pdf)

çojë në rënie të ndjeshme të normave të rritjes, siç shihet në vendet që kanë zbatuar reforma drastike tatimore.

*Dëshmi empirike:* Studimet mbi ndikimin e normave të TVSH-së në rritjen ekonomike në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL-5) tregojnë se ndërsa normat e TVSH-së mund të kenë një ndikim pozitiv afatshkurtër, ato shpesh çojnë në norma më të ulëta të PBB-së në afatgjatë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për vendet me norma të larta të TVSH-së fillestare..

*Efektet makroekonomike:* Sipas studimit “A study on the economic effects of the current VAT rates structure” mbi efektet ekonomike të reformave të TVSH-së në BE zbuloi se rritja e të ardhurave të TVSH-së nëpërmjet rritjes së normës standarde mund të çojë në ulje të PBB-së, konsumit, punësimit dhe tregtisë ndërkombëtare. Megjithatë, ulja e normave të TVSH-së duke ruajtur neutralitetin e të ardhurave mund të çojë në efekte të vogla pozitive mbi PBB-në dhe punësimin.

*Ndikimet e politikës:* Natyra jolineare e ndikimit të TVSH-së në rritje nënkupton që politikëbërësit duhet të jenë të kujdesshëm kur rrisin normat e TVSH-së. Normat e moderuara mund të kenë efekte minimale, por normat e larta mund të kenë ndikime negative të rënda dhe afatgjata në rritjen ekonomike.

## **Të ardhurat personale dhe ndikimi në ekonomi<sup>4</sup>**

Normat e tatimit mbi të ardhurat personale mund të ndikojnë në rritjen ekonomike në disa mënyra. Sipas një studimi të William G. Gale & Andrew A. Samwick mbi rolin e tatimit të të ardhura personale dallohen disa veçori:

*Përgjigjet e sjelljes:* Ndryshimet e normës së tatimeve mund të ndikojnë në vendimet individuale dhe të biznesit. Për shembull, ulja e normave marxhinale të tatimeve mund të rrisë aktivitetin ekonomik duke inkurajuar punën dhe investimet, ndërsa rritja e normave mesatare të tyre mund të reduktojë konsumin dhe investimet.

*PBB dhe Papunësia:* Ndryshimet në normat e tatimit mbi të ardhurat personale mund të ndikojnë në GDP dhe normat e papunësisë. Për shembull, një ulje prej 1% në normën mesatare të tatimit mund të çojë në një rritje prej 0,5% të të ardhurave reale personale dhe një rritje prej 0,4% të PBB-së reale.

*Efektet Afatgjata:* Efektet afatgjata të normave të tatimit mbi të ardhurat personale në rritjen ekonomike janë komplekse dhe varen nga struktura e sistemit tatimor. Për shembull, një kalim nga një sistem tatimor i sheshtë në një sistem progresiv mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike.

*Politika Fiskale:* Financimi i ndryshimeve tatimore është vendimtar. Nëse shkurtimeve të tatimeve nuk shoqërohen me shkurtime të shpenzimeve, ato mund të çojnë në rritje të deficiteve buxhetore, të cilat mund të reduktojnë kursimet kombëtare dhe të rrisin normat e interesit, duke kompensuar potencialisht çdo përfitim nga rritja.

Në përmbledhje, normat e tatimit mbi të ardhurat personale mund të ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike duke ndikuar në stimujt, përpjekjet e punës dhe konsumin, me norma më të larta që përgjithësisht kanë ndikime negative në rritjen afatgjatë.

---

<sup>4</sup> Effects of Income Tax Changes on Economic Growth, William G. Gale & Andrew A. Samwick, 2016.

## **Komponentë të tatimit në ndryshimet ekonomike**

Ndikimet ekonomike të ndryshimeve tatimore në rritjen ekonomike, të matura si një ndryshim në PBB-në reale ose në komponentët e PBB-së si konsumi dhe investimet, janë të vështira për t'u matur. Disa ndryshime tatimore ndodhin si përgjigje ndaj rritjes ekonomike, dhe shikimi i një ulje të tatimeve në një moment të caktuar në kohë mund të çojë në përfundimin e gabuar se shkurtimeve e tyre janë të këqija për rritjen ekonomike, pasi shkurtimeve/ uljet e normave tatimore shpesh zbatohen gjatë rënies ekonomike.

Mertens dhe Olea (2018) përdorën të dhëna nga 1946 deri në 2012 për të vlerësuar ndikimet e normave marxhinale të tatimeve në të ardhurat individuale. Ata zbuluan se shkurtimeve marxhinale të normave çuan në rritje të PBB-së reale dhe në rënie të papunësisë në SHBA. Një rënie me 1 përqind e normës tatimore rrit PBB-në reale me 0.78 përqind në vitin e tretë pas ndryshimit të tatimeve. Megjithatë, shkurtimeve e tatim- taksave për 1 përqindëshin e shtresës së pasur rritin pabarazinë.

Ljungvist dhe Smolyansky (2018) kanë studiuar 250 ndryshime të tatimeve shtetërore të korporatave nga 1970-2010 për të vlerësuar ndikimin e tyre në punësim dhe të ardhura. Ata zbulojnë se një ulje me 1 përqind në normat ligjore të tatimit të korporatave çon në një rritje prej 0.2 përqind të punësimit dhe një rritje prej 0.3 përqind të pagave.

Një vlerësim i drejtë do të konkludonte se politikat tatimore të hartuara mirë kanë potencialin për të rritur rritjen ekonomike, por ka shumë pengesa gjatë rrugës dhe sigurisht asnjë garanci që të gjitha ndryshimet tatimore do të përmirësojnë performancën ekonomike. Duke pasur parasysh kanalet e ndryshme përmes të cilave politika tatimore ndikon në rritje, një ndryshim tatimor do të jetë më nxitës i rritjes deri në masën që përfshin (i) efekte të mëdha stimuluese (zëvendësuese) pozitive që inkurajojnë punën, kursimet dhe investimet; (ii) efekte të vogla ose negative të të ardhurave, duke përfshirë një shënjestrim të kujdesshëm të uljeve të tatim- taksave drejt aktivitetit të ri ekonomik, në vend që të sigurojë fitime të papritura për aktivitetet e mëparshme; (iii) reduktimet e shtrembërimeve nëpër sektorë ekonomikë dhe në lloje të ndryshme të ardhurash dhe konsumi; dhe (iv) rritje minimale ose ulje të deficitit buxhetor.

## Rreth politikave tatimore të BE<sup>5</sup>

Politikat bashkëkohore tatimore synojnë shumë objektiva. Tatimi synon të mbledhë fondet e nevojshme për shpenzimet publike, të rishpërndajë të ardhurat, të stabilizojë ekonominë, të kapërcejë ekstremitetet, të ndikojë në shpërndarjen e burimeve, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të jetë mbështetës për rritjen ekonomike. Qëllimi i tatimit të dizajnuar në mënyrë efikase është të arrijë objektivat e dëshiruara të politikës fiskale (ndarja, rishpërndarja dhe stabilizimi) në mënyrën më efikase, domethënë duke kufizuar shtrembërimet e padëshiruara, duke minimizuar koston e mbledhjes së tatim- taksave dhe duke nxitur rritjen ekonomike. Efikasiteti i tatimeve dhe veçanërisht struktura tatimore luan një rol të rëndësishëm në arritjen e rritjes ekonomike dhe konsolidimit fiskal. Sipas teorisë ekonomike, taksimi krijon shtrembërimet, si edhe në këmbim mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Duke marrë parasysh thjesht një funksion prodhimi, është e qartë se tatimi mund të ndikojë në rritje nëpërmjet ndikimit të tij në (1) kapitalin fizik, (2) kapitalin njerëzor dhe (3) nëpërmjet efektit të tij në produktivitetin total të faktorëve. Sipas disa studimeve, tatimi mbi të ardhurat e korporatave dhe ato personale janë më të dëmshmet për rritjen, ndërsa tatimi mbi konsumin, mjedisin dhe pronën janë më pak të dëmshme (OECD, 2008).

Sipas studimit “An empirical evidence for the impact of taxation on economy growth in the European Union” të Desislava Stoilova & Nikolay Patonov mbi efektet tatimore në BE, të ardhurat nga tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore përbëjnë mbi 91% të totalit të të ardhurave të përgjithshme të qeverive në Bashkimin Evropian. Gjatë 2010-2013 barra totale tatimore në BE ka rënë, për shkak të krizës ekonomike dhe financiare botërore. Rënia ishte më e theksuar midis viteve 2008 dhe 2009. Në vitin 2010 të ardhurat totale tatimore në terma të PBB-së arritën pikën më të ulët në periudhën nga viti 1995 e në vazhdim.

Sipas bazës së të dhënave të Eurostat në vitin 2010, të ardhurat tatimore qëndruan në 39,6 % të PBB-së në Bashkimin Evropian (27) dhe 40,2 % të PBB-së në zonën e euros (17). Ka shumë arsye për ndryshime të konsiderueshme në të ardhurat totale nga tatim- taksat dhe kontributet sociale

---

<sup>5</sup> An Empirical Evidence For The Impact Of Taxation On Economy Growth In The European Union, Desislava Stoilova & Nikolay Patonov, 2013.



gjatë periudhës së analizuar. Për më tepër, shkaqet e këtyre luhatjeve në secilin vend të veçantë janë të ndryshme. Në përgjithësi, ndër parakushtet bazë janë ndryshimet në aktivitetin ekonomik, që ndikojnë në nivelet e punësimit dhe shitjet e mallrave dhe shërbimeve, ndryshimet në legjislacionin tatimor, që ndikojnë në anatominë tatimore, si dhe ndryshimet në nivelin e PBB-së.

Kriza ekonomike dhe financiare botërore, paralelisht me masat e politikës fiskale, të miratuara në vendet anëtare të BE-së, pati një ndikim të fortë në nivelin dhe përbërjen e të ardhurave totale nga tatimet dhe kontributet sociale gjatë tre viteve të fundit të periudhës së analizuar. Në vitin 2010, barra totale tatimore në BE (27) u shpërnda relativisht në mënyrë të barabartë ndërmjet tatimeve direkte (31.2%), tatimeve indirekte (33.3%) dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore (35.1%). Të ardhurat nga tatimet direkte janë ulur ndjeshëm gjatë periudhës 2007-2009, duke tejkaluar uljen e PBB-së. Kjo për shkak të krizës ekonomike, e cila ka ndikuar negativisht në fitimet e korporatave dhe të ardhurat personale. Në tërësi, tatimet indirekte kanë formuar një peshë relativisht konstante në totalin e të ardhurave tatimore. Në vitin 2010, të ardhurat nga tatimet indirekte arritën në 13.2% të PBB-së, 12.4% të PBB-së u llogaritën nga tatimet direkte, ndërsa kontributet sociale përfaqësonin 13.9% të PBB-së. Për shkak të sistemeve të ndryshme kombëtare të tatimeve, rëndësia e tatimit indirekt, tatimit direkt dhe kontributeve sociale ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend për sa i përket të ardhurave tatimore të krijuara.

## **Klima e favorshme e biznesit**

Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Një mjedis i dobët biznesi, domethënë i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë pengon zhvillimin ekonomik, e kundërta ndodh nëse shtetet miratojnë politika pro-zhvillim dhe ligje e praktika që mbështesin investimet dhe zhvillimin e biznesit (Mooij, R. A. & Ederveen, S, 2003).

Nëse kërkojmë një përkufizim të saktë për konceptin e klimës së favorshme të biznesit dhe të investimeve, nuk do të mund ta gjenim atë. Megjithatë mund të themi se për shembull Banka Botërore në klimën e biznesit dhe të investimeve përfshin mundësinë dhe nxitësit për kompanitë që të investojnë në mënyrë produktive, të hapin vende pune dhe të zgjerohen (BB dhe IFC, 2009). Në vija të ngjashme, mund të themi se klima e biznesit dhe e investimeve shërben si një kuadër i cili u mundëson kompanive të huaja dhe vendase, të bëjnë biznes dhe të kërkojnë fitime në një vend të caktuar. Në përgjithësi klima e investimeve mund të përkufizohet nga tre variabla:

- Politikat makroekonomike si ato fiskale, monetare dhe tregtare.
- Qeverisja dhe institucionet.
- Infrastruktura.

## **Biznesi i vogël dhe roli i tij në ekonomi<sup>6</sup>**

Na thuhet se nuk ka një përkufizim të pranuar përgjithësisht të një biznesi "të vogël", dhe se shumica e personave që përdorin termin e bëjnë këtë pa pasur parasysh ndonjë përkufizim specific. Sigurisht që mund të klasifikohen firmat e biznesit sipas kriterëve sasiore si numri i punonjësve, aktivet totale ose shitjet totale.

### *Tatimet e larta në bizneset e vogla*

Tatimet e larta mund të ndikojnë në madhësinë dhe forcën e popullsisë së biznesit të vogël në disa mënyra. Ata mund të zvogëlojnë numrin e lindjeve në biznes duke dekurajuar ata që përndryshe mund të krijojnë biznese të reja. Së dyti, ata mund të ngadalësojnë shkalla me të cilën bizneset e vogla janë në gjendje të rriten duke e bërë më të vështirë për ta për të financuar një zgjerim të shpejtë. Dhe së treti, ata mund të dobësojnë dëshirën dhe aftësinë e koncerneve të vogla për të mbijetuar si ndërmarrje të pavarura duke arritur përfitime nga një shitje ose bashkim duken më tërheqëse sesa të ardhurat nga të cilat do të nxirren vazhdimi i funksionimit. Nga përvoja e firmave

---

<sup>6</sup> The impact of taxation on small business, E. Gordon Keit.

individuale mund të argumentohet se tatimet e larta i kanë bërë të tria këto, por nuk ka të dhëna që tregojnë shtrirja e ndikimit në cilindo nga këto drejtime.

### *Norma e ulët tatimore për bizneset e vogla*

Shumica e pengesave tatimore ndaj të cilave i nënshtrohet biznesi i vogël mund të hiqen fare lehtë duke bërë një ulje të konsiderueshme të tatimeve. Kjo është kryesisht për shkak se tatimet janë aq të larta që biznesi i vogël e gjen veten në disavantazh në konkurrencën e saj me firmat më të mëdha. Nëse të gjitha bizneset do të ttoheshin më pak, firmat e vogla do ta gjenin veten në një pozicion relativisht më të forte financiarisht, sepse do të mund të ruanin një përqindje më të madhe të fitimeve të tyre.

## **Normat tatimore dhe indikatorët ekonomikë për vende të ndryshme**

Bazuar në legjislacionin tatimor të secilit prej shteteve më poshtë, si edhe të dhënave zyrtare kemi të dhënat si vijon:

<b>Shteti</b>	<b>Tatimi mbi të Ardhurat Personale</b>	<b>Tatimi mbi Fitimin e Korporatave</b>	<b>TVSH-ja</b>	<b>PBB-ja për Frymë (USD)</b>	<b>Norma e Papunësisë</b>	<b>Rritja Ekonomike (%)</b>
Shqipëria	13%-23%	15%	20%	6,000	11.6%	3.3%
Gjermania	45%	15%	19%	50,000	3.2%	1.5%
SHBA	37%	21%	0%	65,000	3.6%	2.3%
Singapori	22%	17%	7%	59,000	2.2%	3.2%

### **1. Shqipëria**

- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 13%-23%*
- *Tatimi mbi Fitimin e Korporatave: 15%*
- *TVSH: 20%*
- *Efekti në Ekonomi: Normë relativisht e ulët e tatimit mbi të ardhurat personale dhe fitimin e korporatave. Kjo ndihmon në tërheqjen e investimeve të huaja dhe në nxitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme.*

### **2. Gjermania**

- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 45%*
- *Tatimi mbi Fitimin e Korporatave: 15%*

- *TVSH: 19%*
- *Efekti në Ekonomi:* Normat e larta të tatimit mbi të ardhurat personale ndihmojnë në financimin e një sistemi të fortë mirëqenieje dhe shërbimesh publike të avancuara. Kjo ka çuar në ulje të papunësisë dhe një cilësi të lartë të jetesës, por rritja ekonomike është më e ulët krahasuar me vendet me tatime më të ulëta.

### **3. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)**

- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 37%*
- *Tatimi mbi Fitimin e Korporatave: 21%*
- *TVSH: 0%* (nuk ka TVSH federale, por ka tatim- taksa shtetërore)
- *Efekti në Ekonomi:* SHBA ka një normë të lartë të tatimit mbi fitimin e korporatave dhe të ardhurat personale, e cila kontribuon në financimin e një ekonomie të madhe dhe komplekse. Rritja ekonomike është relativisht e qëndrueshme dhe e lartë, ndërsa papunësia është relativisht e ulët. Sistem i diversifikuar tatimesh që mbështet inovacionin dhe sipërmarrjen.

### **4. Singapori**

- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 22%*
- *Tatimi mbi Fitimin e Korporatave: 17%*
- *TVSH: 7%*
- *Efekti në Ekonomi:* Normat e ulëta të tatimit mbi të ardhurat personale dhe fitimin e korporatave e bëjnë Singaporin një vend shumë tërheqës për bizneset dhe investitorët. Kjo ka çuar në rritje të qëndrueshme ekonomike dhe ulje të papunësisë. Politikat fiskale favorizuese kanë nxitur zhvillimin e sektorit teknologjik dhe financiar.

**Shënim:**

Ky material është mbështetur në studime të kryera nga OECD në lidhje me impaktin që kanë politikat e ndryshme tatimore në procesin e zhvillimit ekonomik. Gjithashtu bazohet në literaturë mbi tatimet direkte dhe ato indirekte, si edhe impakti që kanë këto tatime në biznesin e vogël dhe studime të publikuara në faqet studimore si researchgate apo edhe faqe ekonomike si taxfoundation. Po ashtu janë përdorur raporte të kryera nga institute të ndryshme për Komisionin European mbi veçoritë e TVSH-së në ekonomi, si edhe studime mbi efektet ekonomike të tatimit të të ardhurave personale, efektet tatimore në BE dhe të dhëna krahasimore për katër shtete, Literatura e detajuar gjendet në fund të punimit.

## Literatura e përdorur

Effects of Income Tax Changes on Economic Growth, William G. Gale, The Brookings Institution and Tax Policy Center, Andrew A. Samwick, Dartmouth College and National Bureau of Economic Research

The impact of taxation on small business, E. Gordon Keit.

Effects of Income Tax Changes on Economic Growth, William G. Gale & Andrew A. Samwick, 2016.

An Empirical Evidence For The Impact Of Taxation On Economy Growth In The European Union, Desislava Stoilova & Nikolay Patonov, 2013.

The Effect Of Personal Income Tax Rates On Individual And Business Decisions - A Review Of The Evidence, Mark Rider, 2006.

Fundamental principles of taxation [https://www.oecd-ilibrary.org/taxation/addressing-the-tax-challenges-of-the-digital-economy/fundamental-principles-of-taxation\\_9789264218789-5-en;jsessionid=L\\_LwVecexq4tAp8-e7fbA1mxvYiuoSRPdyDGMYS7.ip-10-240-5-72](https://www.oecd-ilibrary.org/taxation/addressing-the-tax-challenges-of-the-digital-economy/fundamental-principles-of-taxation_9789264218789-5-en;jsessionid=L_LwVecexq4tAp8-e7fbA1mxvYiuoSRPdyDGMYS7.ip-10-240-5-72)

[https://taxfoundation.org/research/all/federal/reviewing-recent-evidence-effect-taxes-economic-growth/?t&utm\\_source=perplexity](https://taxfoundation.org/research/all/federal/reviewing-recent-evidence-effect-taxes-economic-growth/?t&utm_source=perplexity)

<https://www.kellogg.northwestern.edu/faculty/rebelo/htm/nonlinear.pdf>

[https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2016-09/vat\\_rates\\_structure\\_final\\_report.pdf](https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2016-09/vat_rates_structure_final_report.pdf)

[https://www.nber.org/system/files/working\\_papers/w28646/w28646.pdf](https://www.nber.org/system/files/working_papers/w28646/w28646.pdf)

<https://www.philadelphiafed.org/-/media/frbp/assets/economy/articles/economic-insights/2021/q3/eiq321-the-economic-effects-of-changes-in-personal-income-tax-rates.pdf>

<https://www.brookings.edu/articles/effects-of-income-tax-changes-on-economic-growth/>

<https://taxfoundation.org/research/all/state/income-taxes-affect-economy/>

<https://www.redalyc.org/pdf/3887/388743876026.pdf>

[https://www.ecb.europa.eu/events/pdf/conferences/ws\\_pubfinance/paper\\_Furceri.pdf](https://www.ecb.europa.eu/events/pdf/conferences/ws_pubfinance/paper_Furceri.pdf)

<https://www.bde.es/f/webpi/SES/seminars/2017/files/sie1713.pdf>

<https://www.fonoa.com/blog/the-american-exception-why-the-us-has-no-vat-system>

<https://taxsummaries.pwc.com/germany/individual/taxes-on-personal-income>

<https://marosavat.com/manual/vat/germany/>

<https://www.singaporelawwatch.sg/About-Singapore-Law/Commercial-Law/ch-28-income-taxation>

<https://www.mof.gov.sg/policies/taxes/goods-and-services-tax>

Ligj Nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar.

Ligj Nr. 92/2014 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë.

German Income Tax Laws